

Rikonceptimi me Guxim i Arsimit Shumëgjuhësh në NYC Public Schools (Shkollat Publike të Nju-Jorkut)

Raport Përmbledhës i Këshillit Konsultativ për Arsimin Shumëgjuhësh në NYC
2025

Hyrje

Në qytetin shumëkulturore dhe shumëgjuhësh të Nju-Jorkut, nxënësit e shkollave publike janë në një pozicion unik për të lulëzuar në një botë ku shumëgjuhësia dhe kompetenca kulturore vlerësohen si aftësi thelbësore. Më shumë se 44% e nxënësve tanë flasin një gjuhë tjetër përveç anglishtes në shtëpi, dhe të gjithë nxënësit së bashku flasin mbi 156 gjuhë. Në klasat tona takohen kulturat dhe gjuhët e ndryshme të botës, duke krijuar një mundësi të pakrahasueshme për të përgatitur të diplomuar të cilët, përmes larmisë së përvojave dhe ekspozimit të tyre, zhvillojnë kreativitetin, komunikimin, ndjeshmërinë kulturore dhe ndërgjegjësimin global për të pasur sukses dhe për të udhëhequr në një botë të ndërlidhur, si dhe për të formësuar të ardhmen me besim dhe qëllim.

Ky raport përmbledhës ofron një pasqyrë të gjetjeve dhe rekomandimeve të Këshillit Konsultativ për Arsimin Shumëgjuhësh të NYC, një grup i larmishëm nxënësish, familjesh, arsimtarësh, drejtuesish shkollash dhe distriktesh, si dhe avokatësh nga të pesta zonat e qytetit. Puna e fortë e këtij Këshilli Konsultativ hedh themelet për një plan strategjik pesëvjeçar, i cili synon të zgjerojë rrugët drejt shumëgjuhësisë dhe udhëheqjes globale për të gjithë nxënësit e shkollave publike të NYC-së, duke siguruar që nxënësit tanë që mësojnë anglisht si gjuhë të dytë të jenë të përgatitur për sukses. Kjo punë gjithashtu krijon një bazë për advokim dhe krijimin e komunitetit të nevojshëm për të zbatuar planin.

Një raport i plotë dhe gjithëpërfshirës, i cili vendos punën dhe rekomandimet e Këshillit Konsultativ në kontekstin historik dhe në peizazhin aktual të arsimit shumëgjuhësh në NYCPS, do të publikohet gjatë këtij viti shkollor.

vështrim mbi Termat Kryesorë

Në të gjithë raportin përdoren termat e mëposhtëm:

- **Gjuha e shtëpisë** - Gjuha kryesore që nxënësi flet në shtëpi. Gjatë vitit shkollor 2024-25, rreth 44% e nxënësve të NYC Public School (Shkollat Publike të NYC) flisnin një gjuhë të ndryshme nga anglishtja në shtëpi.
- **Nxënës që mëson anglisht** - Nxënës i gjuhës angleze, ose ELL, i cili nuk ka anglishten si gjuhë kryesore të folur në shtëpi dhe ka rezultate nën nivelin e zotërimit të gjuhës angleze në Testin e Identifikimit të Nxënësve që Mësojnë Anglisht të NYS (NYSITELL). Gjatë vitit shkollor 2024-25, rreth 19% e nxënësve të NYCPS ishin ELL.
- **Nxënës shumëgjuhësh** - Nxënësit shumëgjuhësh, ose ML, përfshijnë nxënësit që mësojnë aktualisht anglisht (ELL), nxënësit që dikur kanë qenë ELL, nxënësit që nuk kanë qenë kurrë ELL, por janë folës të një gjuhe tjetër të trashëguar përveç anglishtes, si dhe nxënësit e gjuhëve të huaja. *Shënim:* New York State Education Department (Departamenti i Arsimit i Shtetit të Nju-Jorkut) dhe NYCPS i referohen nxënësve të gjuhës angleze (ELL) si nxënës shumëgjuhësh/nxënës që mësojnë anglisht (ML/ELL), përveç rasteve që lidhen me politikën shtetërore.
- **Imigrant** - Një person i cili vjen për të jetuar përgjithmonë në një vend ku ka migruar. *Shënim:* NYCPS nuk kërkon dhe nuk mbledh informacion për statusin e imigracionit të nxënësve nga kopshti deri në klasën 12 ose të familjeve të tyre.

Këshilli Konsultativ për Arsimin Shumëgjuhësh në NYC

Përmbledhje rreth Këshillit dhe Qëllimit të tij

Në 50-vjetorin e dekretit të pëlqimit të Aspira-s (Aspira Consent Decree), NYCPS shpalli ngritjen e Këshillit Konsultativ për Arsimin Shumëgjuhësh të NYC-së për të zhvilluar një strategji të informuar nga komuniteti me qëllim *rikonceptimin me guxim të arsimit shumëgjuhësh*. Më shumë se 375 nxënës, familje, arsimtarë dhe anëtarë të komunitetit shprehën interesin për të marrë pjesë në Këshillin Konsultativ përmes një procesi të hapur aplikimi. Një ekip prej 15 anëtarësh nga NYCPS shqyrtoi aplikimet me qëllim krijimin e një këshilli që reflekton diversitetin e qytetit - duke marrë parasysh gjuhët e folura, përfaqësimin sipas borough dhe nivelit të klasës, si dhe njohuritë personale ose profesionale mbi përvojën e nxënësve shumëgjuhësh dhe imigrantë.

Një grup përfundimtar prej mbi 50 këshilltarësh u zgjodh për të shërbyer në Këshillin Konsultativ (shih listën e plotë në faqen [Multilingual NYC](#)) dhe u angazhua në nëntor 2024. Këshilltarët u caktuan në nënkomitete të fokusuara në tre fusha: Shkolla mikpritëse dhe gjithëpërfshirëse, rrugët drejt shumëgjuhësisë dhe përgatitja e drejtuesve globalë. Secili nënkomitet udhëhiqej nga një drejtues i NYCPS-së dhe një bashkëudhëheqës komuniteti nga Këshilli Konsultativ.

Midis dhjetorit 2024 dhe qershorit 2025, këshilltarët u takuan si një grup i plotë i këshillit konsultativ, me nënkomitetet e tyre, dhe për seanca të veçanta të fokusuara në tema specifike. Takimet përfshinë prezantime nga aktorë të ndryshëm, përfshirë anëtarë të Office of Multilingual Learners (Zyra për Nxënësit Shumëgjuhësh) dhe zyra të tjera brenda NYCPS-së, diskutime në dhoma të veçanta dhe punë bashkëpunuese për të shqyrtuar dhe zhvilluar rekomandime.

Gjetjet nga Këshilli Konsultativ

Gjatë punës së tyre tetëmuajore, këshilltarët trajtuan ndërlikimet e arsimit shumëgjuhësh në NYCPS dhe ndanë perspektiva të larmishme, të nxjerra nga përvoja të jetuara dhe ekspertiza profesionale. Ata shqyrtuan të dhënat e gjendjes aktuale, bënë pyetje sfiduese dhe morën pjesë në diskutime të përsëritura. Përmes këtij procesi, këshilltarët identifikuan sfida dhe mundësi të qarta në punën e rikonceptimit me guxim të arsimit shumëgjuhësh në NYCPS. Një përmbledhje e gjetjeve paraqitet më poshtë dhe zgjerohet më tej në raportin e plotë.



Gjetjet Kryesore

- **Aksesi në programe cilësore:** NYCPS përballet me një akses të pabarabartë në programet cilësore të arsimit dygjuhësh (përfshirë arsimin në dy gjuhë dhe arsimin kalimtar në dy gjuhë), programet vetëm për mësimin e anglishtes si gjuhë të re (ENL), si edhe mundësitë për kurse të gjuhëve të huaja dhe të gjuhëve të trashëgimisë, në distrikte ku mungojnë materialet mësimore të mjaftueshme dhe ka mangësi në burimet për nxënësit ELL.
- **Shkolla gjithëpërfshirëse:** Shumë shkolla hasin vështirësi në përmbushjen e plotë të nevojave të ndërlikuara të nxënësve dhe familjeve shumëgjuhëshe e imigrante, pavarësisht statusit të tyre të imigracionit¹, megjithëse programe dhe nisma si Dream Squads dhe Projekti Open Arms nxjerrin në pah praktika efektive dhe gjithëpërfshirëse.
- **Mungesat e mësuesve:** NYCPS përballet me mungesa të vazhdueshme të mësuesve të arsimit dygjuhësh dhe të gjuhëve të huaja dhe ka nevojë për një strategji të qëndrueshme për përgatitjen e mësuesve, rekrutimin e arsimtarëve shumëgjuhësh dhe zhvillimin profesional, në mënyrë që të gjithë mësuesit të jenë të aftë për të mbështetur nxënësit që mësojnë anglishten si gjuhë të dytë (ELL).
- **Përfshirja e familjeve:** Megjithëse janë zgjeruar burimet e aksesit gjuhësor, barrierat e vazhdueshme gjuhësore dhe strukturat e paaksesueshme kufizojnë aftësinë e familjeve për të marrë pjesë si partnerë të vërtetë në arsimimin e fëmijëve të tyre, si advokues dhe vendimmarrës.
- **Përgatitja për kolegji dhe karrierë:** Barrierat në aksesin në kurse të avancuara, të nxënësve me bazë punën dhe programin e certifikimit të dygjuhësisë i pengojnë nxënësit shumëgjuhësh dhe imigrantë të zhvillojnë plotësisht aftësitë, njohuritë dhe mundësitë që mbështesin suksesin akademik afatgjatë, stabilitetin financiar dhe përparimin në karrierë.

Temat Kryesore nga Gjetjet

Për të mbështetur zbatimin e një plani strategjik për të rikonceptuar me guxim arsimin shumëgjuhësh në NYCPS, nga gjetjet dolën katër tema kryesore si faktorë vendimtarë për të siguruar progres dhe ndikim pozitiv për nxënësit dhe familjet shumëgjuhëshe dhe imigrante

- **Vendosja e standardeve të qarta në të gjithë sistemin për cilësinë dhe aksesin** në arsimin dygjuhësh dhe hartimin, ofrimin dhe vazhdimësinë e programit të anglishtes si gjuhë e re (ENL).

¹ NYCPS nuk kërkon dhe nuk mbledh informacion për statusin e imigracionit të nxënësve nga kopshti deri në klasën 12 ose të familjeve të tyre

- **Përmirësimi i aksesit në të dhëna dhe informacione** për t'i ndihmuar familjet të kuptojnë programet dhe politikat që ndikojnë te fëmija i tyre dhe për t'i fuqizuar si partnerë të vërtetë në edukimin e fëmijës së tyre.
- **Prioritizimi i burimeve dhe financimit** për të mbështetur rezultate të barabarta për nxënësit shumëgjuhësh dhe imigrantë në iniciativat kryesore të NYCPS.
- **Përvetësimi i një qasjeje të bazuar tek asetet**, që njeh aftësitë dhe potencialin e nxënësve shumëgjuhësh, siç dëshmohet nga arritjet e nxënësve ELL krahasuar me bashkëmoshatarët e tyre që nuk kanë qenë kurrë ELL.

Prioritetet

Nga këto gjetje, ky raport vendos pesë prioritate kryesore. Së bashku, këto prioritate përcaktojnë angazhimin tonë ndaj nxënësve dhe familjeve shumëgjuhëshe dhe imigrante në shkollat tona dhe ofrojnë një kuadër për të siguruar që përfshirja, aksesueshmëria dhe ekselencia të jenë të integruara në planin e rikonceptimit me guxim të arsimit shumëgjuhësh në NYCPS.

- **Prioriteti 1:** Krijimi i programeve shumë cilësore drejt shumëgjuhësisë me akses të barabartë për nxënësit ELL
- **Prioriteti 2:** Forcimi dhe zgjerimi i një stafi të përgjegjshëm në aspektin kulturor dhe gjuhësor
- **Prioriteti 3:** Promovimi i një kulture përfshirjeje dhe i ndjenjës së përkatësisë për nxënësit dhe familjet shumëgjuhëshe dhe imigrante
- **Prioriteti 4:** Nxitja e lidershit dhe advokimit të familjeve dhe komunitetit shumëgjuhësh dhe imigrant
- **Prioriteti 5:** Njohja e shumëgjuhësisë si një kompetencë themelore për përgatitjen për kolegji, karrierë dhe qytetari

Rekomandime

Prioriteti 1: Krijimi i programeve shumë cilësore drejt shumëgjuhësisë me akses të barabartë për nxënësit ELL

1.1 Përmirësimi i disponueshmërisë dhe cilësisë së programeve dygjuhëshe

- 1.1a Të gjitha distriktet duhet të rrisin disponueshmërinë e programeve të arsimit dygjuhësh me cilësi të lartë, përfshirë programet arsimore dygjuhëshe, në të gjitha nivelet e klasave dhe të ndërmarrin masa për të rritur aksesin e nxënësve që mësojnë gjuhën angleze (ELL).

- 1.1b NYCPS duhet të punojë si në nivel qendror, ashtu dhe me distriktet dhe shkollat, për të siguruar që të gjitha programet e arsimit dygjuhësh të kenë më shumë akses në kurrikula dhe materiale cilësore në gjuhën e programit.
- 1.1c NYCPS duhet të punojë si në nivel qendror, ashtu dhe me distriktet dhe shkollat, për të siguruar që të gjitha programet e arsimit dygjuhësh të kenë më shumë akses në mjetet e vlerësimit për nxënësit në anglisht dhe gjuhën tjetër të programit, për të monitoruar përparimin dhe zhvillimin si përgjigje ndaj mësimdhënies dhe për të parashikuar rrezikun e vështirësive në lexim në të dyja gjuhët e programit.

1.2 Përmirësimi i programeve ENL

- 1.2a Të gjitha shkollat duhet të zbatojnë bashkë-mësimdhënie të integruar ENL me efikasitet të lartë, duke ndjekur udhëzimet për të programuar në mënyrë të përshtatshme dyshtet e mësuesve ENL, për të caktuar kohë të mjaftueshme dhe të rregullt për bashkëplanifikim dhe për të prioritetizuar pjesëmarrjen e përbashkët të dyshtes së mësuesve në trajnime profesionale.
- 1.2b NYCPS duhet të zgjerojë kurrikulën bazë duke përfshirë një program të veçantë për zhvillimin e gjuhës angleze (ELD), i cili është i përshtatshëm për çdo nivel klase, me qëllim ofrimin e komponentit të pavarur mësimor të anglishtes si gjuhë e re, nga kopështi deri në klasën 12.

1.3 Përmirësimi i programeve të gjuhëve botërore dhe të trashëgimisë dhe i disponueshmërisë së tyre

- 1.3a Shkollat dhe distriktet duhet të ofrojnë më shumë akses në kurse të gjuhëve të huaja dhe të trashëgimisë.
- 1.3b NYCPS duhet të zgjedhë dhe të mbështesë kurrikulën bazë të standardizuar për programet e gjuhëve të huaja dhe të trashëgimisë.

1.4 Masat në nivelin e sistemit për përmirësimin e programeve dhe shërbimeve ELL

- 1.4a NYCPS duhet të kryejë një analizë të kostove të niveleve aktuale të financimit për nxënësit që mësojnë gjuhën angleze (ELL) sipas formulës aktuale të financimit të drejtë të nxënësve të NYCPS.
- 1.4b NYCPS duhet të lehtësojë një studim afatgjatë mbi përfitimet e programeve të arsimit dygjuhësh në NYCPS dhe të identifikojë treguesit kyç të cilësisë që duhet të ketë programi për të arritur këto përfitime.
- 1.4c NYCPS duhet të zgjerojë raportimin publik të të dhënave për të gjitha programet e nxënësve të gjuhës angleze dhe të sigurojë që informacioni të jetë në format shumëgjuhësh, praktik dhe i aksesueshëm për familjet, komunitetin dhe vendimmarrësit.

Prioriteti 2: Forcimi dhe zgjerimi i një stafi të përgjegjshëm në aspektin kulturor dhe gjuhësor

- 2.1 NYCPS duhet të thellojë investimet financiare dhe programatike në programin “Grow Your Own” dhe në programe të tjera të rekrutimit, me qëllim zgjerimin dhe diversifikimin e burimeve të mësuesve të certifikuar për të punuar në arsimin dygjuhësh, në programet e anglishtes si gjuhë e re dhe të gjuhëve të huaja.
- 2.2 NYCPS duhet të zhvillojë drejtime të forta zhvillimi profesional në shkallë qyteti për mësuesit e arsimit dygjuhësh, mësuesit e programeve ENL dhe mësuesit e gjuhëve të huaja, si pjesë e kuadrit arsimor të iniciativës FutureReadyNYC.
- 2.3 NYCPS duhet të zgjerojë mbledhjen dhe analizën e të dhënave mbi nevojat aktuale dhe të pritshme lidhur me fuqinë punëtore në programet e arsimit dygjuhësh, ENL-së dhe të gjuhëve të huaja.
- 2.4 NYCPS dhe institucionet e arsimit të lartë (IHE-t) duhet të bashkëpunojnë për të siguruar që programet e përgatitjes së mësuesve të jenë në përputhje me nevojat e larmishme dhe shumëgjuhëshe të nxënësve të NYCPS-së dhe të distrikteve arsimore që u shërbejnë atyre.
- 2.5 Të gjithë mësuesit dhe drejtuesit e shkollave duhet të marrin trajnim dhe mjete mbështetëse për të përmbushur nevojat akademike, sociale-emocionale dhe gjuhësore të nxënësve që mësojnë gjuhën angleze dhe të nxënësve emigrantë, pavarësisht statusit të tyre të imigrimit, duke siguruar mjedise gjithëpërfshirëse dhe mbështetëse në çdo nivel arsimor.
- 2.6 Të gjitha shkollat duhet të caktojnë një Koordinator për nxënësit ELL, i cili do të ofrojë mbështetje dhe do të mbikëqyrë zbatimin e politikave dhe arritjet akademike të këtyre nxënësve.
- 2.7 NYCPS, Institucionet e Arsimit të Lartë (IHE-të) dhe Federata e Bashkuar e Mësuesve duhet të bashkëpunojnë për të institucionalizuar zhvillimin profesional në kuadër të Programit të Edukimit të Vazhdueshëm për Mësuesit dhe Drejtuesit (CTLE), me fokus te ML-të/ELL-të për të gjithë arsimtarët.

Prioriteti 3: Promovimi i një kulture përfshirjeje dhe i ndjenjës së përkatësisë për nxënësit dhe familjet shumëgjuhëshe dhe imigrante

- 3.1 Çdo distrikt duhet t'u ofrojë shkollave informacion, trajnim dhe mbështetje për partneritet me organizatat me bazë komunitare, për t'iu shërbyer nevojave të nxënësve dhe familjeve të tyre shumëgjuhëshe dhe imigrante.
- 3.2 Çdo shkollë duhet të ketë një ekip arsimtarësh dhe stafi të trajnuar për të vepruar si advokues të nxënësve shumëgjuhësh dhe imigrantë dhe të familjeve të tyre, me një koordinator të caktuar që të shërbejë si ndërlidhës me zyrat e distriktit dhe ato qendrore.

- 3.3 NYCPS duhet të vazhdojë të investojë dhe të zgjerojë aksesin në një kurrikul që i përgjigjet aspekteve kulturore dhe gjuhësore, me kontributin e komunitetit.
- 3.4 Të gjitha shkollat duhet të ndërmarrin hapa për të siguruar që identitetet dhe gjuhët e ndryshme të nxënësve dhe familjeve të pasqyrohen në materialet e klasës dhe bibliotekës.
- 3.5 Të gjitha shkollat duhet të planifikojnë dhe dizajnojnë hapësira që janë mirëpritëse dhe gjithëpërfshirëse për familjet shumëgjuhëshe dhe imigrante (p.sh., dhoma kujdesi, tabelat informuese, qendra mirëseardhjeje, dhomat e familjeve etj.).

Prioriteti 4: Nxitja e lidërshiptit dhe advokimit të familjeve dhe komunitetit shumëgjuhësh dhe imigrant

- 4.1 NYCPS duhet të ndërmarrë hapa për të siguruar që familjet shumëgjuhëshe dhe imigrante të jenë të përfaqësuara dhe të përfshira aktivisht në udhëheqjen dhe vendimmarrjen e këshillave arsimorë të qytetit dhe komunitetit, si dhe të mbështeten për të marrë pjesë në vendimmarrjen në nivel shkollor.
- 4.2 Të gjithë anëtarët e këshillave arsimorë të qytetit dhe komunitetit duhet të marrin trajnim mbi burimet për familjet shumëgjuhëshe dhe imigrante dhe mbi mënyrat e mbështetjes së rrugëve drejt shumëgjuhësisë.
- 4.3 Të gjitha shoqatat prind-mësues (PTA), ekipet drejtuese të shkollave (SLT), ekipet drejtuese të distriktit (DLT) dhe këshillat e prindërve që mbështesin arsimin në fëmijërinë e hershme duhet të marrin trajnim mbi burimet dhe mbështetjen për nxënësit dhe familjet shumëgjuhëshe dhe emigrante, duke përfshirë shërbimet e përkthimit, me qëllim krijimin e partneriteteve më të thella shkollë-familje dhe mundësive për udhëheqje të familjeve shumëgjuhëshe dhe imigrante.

Prioriteti 5: Njohja e shumëgjuhësisë si një kompetencë themelore për përgatitjen për kolegji, karrierë dhe qytetari

- 5.1 Të gjitha shkollat e mesme duhet të ofrojnë certifikimin e dygjuhësisë të Shtetit të Nju-Jorkut (NYSSB).
- 5.2 NYCPS duhet të zgjerojë partneritetet me institucionet e arsimit të lartë për të dhënë kredite për kolegji për të diplomuarit e shkollave të mesme të larta në NYCPS që kanë fituar NYSSB.
- 5.3 Të gjitha shkollat e arsimit të mesëm të lartë duhet të rrisin aksesin në kredite e hershme për kolegji, duke e vënë theksin te mundësitë e regjistrimit të dyfishtë me kredite për nxënësit shumëgjuhësh dhe imigrantë.
- 5.4 NYCPS duhet të zgjerojë programet e lidërshiptit të nxënësve që theksojnë fuqinë e shumëgjuhësisë dhe lidërshiptit global.

- 5.5 Të gjitha shkollat e mesme duhet të zgjerojnë pjesëmarrjen e nxënësve shumëgjuhësh dhe imigrantë në mësimdhënie të lidhur me karrierën, përvoja mësimore me bazë në punë, mentorim dhe mundësi rrjetëzimi.
- 5.6 NYCPS duhet të sigurojë që zbatimi i Portretit të të Diplomuarve të përfshijë përkufizime dhe procese për demonstrimin e aftësive që marrin parasysh pikat e forta të nxënësve shumëgjuhësh dhe imigrantë, duke përfshirë aftësitë e tyre gjuhësore dhe kompetencën kulturore.

Perspektiva për të ardhmen

Në partneritet të vazhdueshëm me Këshillin Konsultativ dhe komunitetin më të gjerë, NYCPS është e përkushtuar për t'i kthyer këto rekomandime në ndryshim të qëndrueshëm. Duke vlerësuar dhe duke u mbështetur në aftësitë gjuhësore dhe kompetencën ndërkulturore të nxënësve tanë shumëgjuhësh dhe imigrantë, si dhe duke promovuar këto pika të forta për të gjithë, ne do të vendosim një standard kombëtar për arsimin shumëgjuhësh dhe për shkollat mikpritëse dhe gjithëpërfshirëse ku nxënësit ndjejnë një ndjenjë qëllimi dhe përkatësie, krenohen me identitetin e tyre dhe diplomohen të gatshëm për të udhëhequr, kontribuar dhe lulëzuar në komunitetin e tyre dhe në botë.

Lexoni raportin e plotë dhe gjeni më shumë informacion mbi përpjekjet e NYCPS-së për të zbatuar rekomandimet e Këshillit Konsultativ në [faqen shumëgjuhëshe të internetit të NYCPS në NYC](#).

Falënderime

Kryetarët e Këshillave Konsultativë 2025

- Dr. Brenda Garcia - Përgjegjëse për Nxënësit Shumëgjuhësh, NYCPS
- Lois Jenkins, Drejtoreshë e Përgatitjes për Kolegj të Nxënësve ML/ELL, NYCPS
- Moumita Zaman - Drejtor i Asociuar për Zhvillimin e Kapaciteteve të Nxënësve Shumëgjuhësh dhe Imigrantë, NYCPS
- Arlen Benjamin-Gomez - Prind/Kujdestar, Drejtoreshë Ekzekutive, EdTrust-Nju-Jork
- Dr. Kristy De La Cruz - Mbikëqyrëse Arsimore, Distrikti Arsimor i Komunitetit 4
- Lara Evangelista - Drejtoreshë Ekzekutive, Rrjeti Internationals Network for Public Schools

Anëtarët e Këshillit Konsultativ 2025

- Afsana Haque - Prind/Kujdesar, P.S. X014 Senator John Calandra
- Alan Cheng - Mbikëqyrës i Arsimit, Konsorciumi, Ndërkombëtar, NYC Outward Bound Schools
- Alfonso Guzman – Drejtor, Pjesëmarrja e Prindërve dhe Familjeve, INCLUDEnyc
- Ameria Alleyne – Prind/Kujdestare, Advokuese, Good Shepherd Services
- América Cañas Garcia – Prind/Kujdestare, Zëvendëspresidene e Lartë, United Way of New York City
- Carmen Diaz-Malvido – CEO (Drejtoreshë Ekzekutive), ASPIRA of New York Inc.
- Dr. Chandler Patton Miranda – Prind/Kujdestar, Asistentprofesor, Liderशिpi Arsimor për Komunitete të Ndryshme Mësimore, Universiteti Molloy
- Dr. Darling James Miramey – Prind/Kujdestar, Multilingual NYC – Partneriteti për Arsimin Shumëgjuhësh në NYC
- Dominika McPartland – Administratore e Shërbimeve ML/ELL në Shkollat e Transferimit, Hunter College (CUNY), Ndihmëslektore e TESOL, Delegete e Gjuhës Polake në NYSABE

- Edward Herrera - Psikolog i Shkollave Dygjuhëshe, P.S. 177, The Marlboro
- Emilia Fiallo - Themeluese e UndocuTeacher
- Erika Abelon - Drejtoreshë e Iniciativave Strategjike, Zyra e Dekanit të Universitetit për Arsimin, CUNY
- Erum Hanif – CEO (Drejtoreshë Ekzekutive) dhe Anëtare e Bordit, Qendra Komunitare APNA Brooklyn Community Center
- Dr. Fabienne Doucet – Drejtoreshë Ekzekutive, Qendra Metropolitane, Universiteti i Nju-Jorkut
- Geyser Rodriguez – Mësuese, East Bronx Academy for the Future
- Hanan Fahmy – Zëvendësdrejtoreshë, P.S. 206, Joseph F Lamb
- Israt Nali - Zëvendësdrejtoreshë, P.S. 214, Michael Friedsam
- Dr. Jo Ann Benoit – Drejtoreshë Ekzekutive e Mbështetjes dhe Operacioneve Shkollore, Distrikti Arsimor i Komunitetit 28
- John Sullivan – Mbikëqyrës Arsimor, Distrikti i Shkollave Transferuese
- Juan Camilo Trespalacios – Mësues, P.S. 044, Thomas C. Brown
- Juvanie Piquant – Shefe e Stafit, Anëtare e Këshillit të Qytetit të Nju-Jorkut, Rita Joseph
- Kaitlin Rosario-Rivera - Mësuese, P.S. 097, Forest Park
- Dr. Kate Menken - Profesoreshë e Linguistikës dhe TESOL, Queens College (CUNY) dhe NYSABE
- Katie Kurjakovic - Specialiste për Nxënësit që Mësojnë Gjuhën Angleze, Sindikata United Federation of Teachers (UFT)
- Vlad Tlali – Strateg i Lartë Politikash, New York Immigration Coalition
- Yasmin Naji – Menaxhere e Lartë e Politikave Arsimore, New York Immigration Coalition
- Dr. Laura Ascenzi-Moreno – Profesoreshë e Arsimit Dygjuhësh, Brooklyn College (CUNY)
- Lilly Chan – Prind/Kujdestare, Mësuese, P.S. 206, Jose Celso Barbosa
- Longping Wong-Qu – Mësues, Shkolla e Mesme e Lartë e Njutaunit

- Maggie Sanchez – Këshilli i Qytetit për Arsimin Special
- Maimouna Dieye – Menaxhere Programi, African Communities Together
- Marisol Castaneda-Salgado - Punonjëse për të Rinjtë, Beam Center
- Melanie Katz - Drejtoreshë, Shkolla e Mesme Franklin D. Roosevelt
- Melissa Scala - Drejtoreshë e ML/ELL në distriktin 75
- Naveed Hasan – Anëtar i Panelit të Prindërve të Zgjedhur për Politikën Arsimore (PEP), Drejtor Themelues i No Limits Learning, Prind/Kujdestar në P.S. 145, Bloomingdale School
- Paola Jordan – Prind/Kujdestar, Drejtoreshë e Qendrës Metropolitane për Prindërit, Sinergia Inc.
- Rita Rodriguez-Engberg – Drejtoreshë e Projektit për të Drejtat e Nxënësve Imigrantë, Advocates for Children
- Ron Woo – Drejtor Ekzekutiv, Rrjeti Rajonal i Burimeve të Arsimit Dygjuhësh në Shtetin e Nju-Jorkut (RBERN)
- Dr. Rosa Rivera-McCutchen – Profesoreshë e Administratës dhe Mbikëqyrjes, Lidërimi Mësimor, Hunter College (CUNY)
- Dr. Sabrin Abedin – Drejtoreshë e ML/ELL, Bronx
- Somia Elrowmeim – Themeluese dhe CEO (Drejtoreshë Ekzekutive), Koalicioni për Fuqizimin e Grave, NYC
- Sonia Sendoya – Punonjëse Sociale, Make the Road New York, Drejtoreshë e Shkollës Komunitare në Kampusin Bushwick
- Steve Weiner – Mësues, “47”- Shkolla e Mesme për Gjuhën Amerikane të Shenjave dhe Gjuhën Angleze
- Tariq Khan – Prind/Kujdestar, P.S. 135, The Bellaire School
- Dr. Tatyana Kleyn – Profesoreshë e Arsimit Dygjuhësh dhe TESOL, City College of New York, CUNY – Iniciativa mbi Imigracionin dhe Arsimin dhe NYSABE (Ish-Presidente)
- Teresa Arboleda – Presidente, Këshilli i Qytetit për Nxënësit që Mësojnë Gjuhën Angleze (CCELL)
- Yasmin Naji – Menaxhere e Politikave Arsimore, New York Immigration Coalition

- Nxënës dhe ish-nxënës të NYC Public Schools (Shkollat Publike të NYC)

Lidërimi dhe Mbështetja për Projektin

Falënderojmë Kancelaren Melissa Aviles-Ramos dhe Zëvendëskancelaren Christina Foti nga Divizioni për të Nxënësit Gjithëpërfshirës dhe të Aksesueshëm (Division of Inclusive and Accessible Learning), për udhëheqjen dhe advokimin e tyre në rikonceptimin e një sistemi që është gjithëpërfshirës dhe i aksesueshëm për të gjithë nxënësit. Falënderojmë stafin e Zyrës për Nxënësit Shumëgjuhësh (Office of Multilingual Learners) dhe të gjithë anëtarët e grupit qendror të punës të NYCPS-së për përkushtimin e tyre ndaj transparencës, hapësirës për dialog dhe kontributeve në krijimin e njohurive të përbashkëta dhe mbështetjen e vendimmarrjes për Këshillin Konsultativ. Së fundi, falënderojmë Anna Pons, Këshilltare Strategjike për Nxënësit Shumëgjuhësh në Divizionin për të Nxënësit Gjithëpërfshirës dhe të Aksesueshëm (Division of Inclusive and Accessible Learning) dhe partnerët tanë në Qendrën për Lidërimin dhe Kërkimin Publik (Center for Public Research and Leadership, CPRL) në Universitetin e Columbia-s, për mbikëqyrjen e këtij projekti dhe drejtimin e përbashkët të seancave tona. Kemi një bazë të fortë për punën që na pret.